



Republika e Kosovës
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council



British Embassy
Pristina



GRUPI PËR STUDIME
JURIDIKE DHE
POLITIKE



MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

ndërmjet:

KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS (KPK) dhe GRUPIT PËR STUDIME JURIDIKE DHE POLITIKE (GLPS)

për implementimin e projektit të titulluar:

“Monitorimi i Sistemit Gjyqësor dhe Prokurorial në Kosovë”

Financuar nga: Ambasada Britanike në Kosovë

20 Maj 2019

Neni 1 [Fushëveprimi]

Ky Memorandum Bashkëpunimi lidhet ndërmjet Këshillit Prokurorial të Kosovës - KPK dhe Grupit për Studime Juridike dhe Politike - GLPS me qëllim të mundësimit të zbatimit të projektit të titulluar: 'Monitoring of the Judicial and Prosecutorial System in Kosovo' (shqip: "Monitorimi i Sistemit Gjyqësor dhe Prokurorial në Kosovë"), financuar nga: Ambasada Britanike në Kosovë, dhe zbatuar nga Grupi për Studime Juridike dhe Politike - GLPS (nr. i regjistrimit 5110959-7).

Neni 2 [Qëllimi i Memorandumit]

Qëllimi i këtij Memorandumi është krijimi i bazave të bashkëpunimit në mes të Këshillit Prokurorial të Kosovës - KPK dhe Grupit për Studime Juridike dhe Politike - GLPS për implementimin e projektit "Monitorimi i Sistemit Gjyqësor dhe Prokurorial në Kosovë". Ky projekt përfshinë monitorimin e punës së Këshillit Prokurorial të Kosovës - KPK dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës - KGJK, të gjitha gjykatave dhe prokurorive në Kosovë.

Neni 3 [Përgjegjësitë e KPK-së]

Këshilli Prokurorial i Kosovës - KPK do të marrë përsipër që të gjithë monitoruesit t'i pajisë me leje hyrje-dalje nëpër objektet e Këshillit Prokurorial të Kosovës - KPK dhe të gjitha prokurorive në Kosovë. Monitoruesve do tu mundësohet përcjellja dhe monitorimi i të gjitha mbledhjeve të Këshillit Prokurorial të Kosovës - KPK. KPK merr përsipër që tu ofrojë qasje në dokumente publike të gjithë monitoruesve, në përputhshmëri me Ligjin 03/L-215 për Qasje në Dokumente Publike përfshirë dokumentet dhe informatat lidhur me punën e KPK-së.

KPK merr përsipër që t'i njoftojë kryeprokurorët e prokurorive themelore në lidhje me projektin e monitorimit. KPK merr përsipër që t'i njoftojë kryeprokurorët e prokurorive themelore lidhur me detyrimin individual të tyre dhe stafit përgjegjës brenda prokurorive gjegjëse (duke mos përfshirë prokurorët) për tu ofruar qasje në dokumente publike të gjithë monitoruesve të projektit, përfshirë këtu çdo informatë dhe dokument në përputhshmëri me Ligjin 03/L-215 për Qasje në Dokumente Publike, duke mos ndërhyrë në ato pjesë të dokumenteve të cilat ende nuk kanë marrë formën e dokumenteve publike sipas ligjit në fjalë.

KPK nuk merr përsipër asnjë detyrim financiar, apo çfarëdo lloji tjetër të shpenzimit në raport me monitoruesit.

Neni 4 [Përgjegjësitë e GLPS-së]

Grupi për Studime Juridike dhe Politike merr përsipër që të menaxhojë në tërësi Projektin 'Monitorimi i Sistemit Gjyqësor dhe Prokurorial në Kosovë', sa i përket përzgjedhjes dhe rekrutimit të monitoruesve në mënyrë transparente dhe bazuar në kritere të qarta të meritës, menaxhimin e mbarëvajtjes së punës së tyre, si dhe monitorimin dhe vlerësimin e punës së tyre të përditshme.

GLPS do të garantojë që çdo monitorues do të nënshkruaj, si kusht për punësim, një deklaratë konfidencialiteti që çdo informacion i marrë sipas procedurave të monitorimit të rasteve prokuroriale do të trajtohet në përputhje me legjislacionin në fuqi që përcakton qasjen në dokumente publike apo në informacione të ndjeshme të karakterit prokurorial.

Më tutje, GLPS do jetë përgjegjëse për kontraktimin e monitoruesve, sipas parimeve të qarta të së drejtës së punës, dhe kompensimin e tyre sipas ligjit në fuqi (përfshirë pagesën e tatimit dhe kontributeve pensionale për ta). Procesi i rekrutimit të monitoruesve do të kalojë në këto faza, së paku:

- a. Shpallja e Thirrjes Publike në gazetën ditore, me detaje të përcaktuara rreth procedurës së rekrutimit dhe kritereve për angazhim;
- b. Organizimi i një procesi intervistimi, dhe përzgjedhja e atyre që më së miri i plotësojnë kushtet;
- c. Organizimi i procesit të rekrutimit do të bëhet në ndërlidhje dhe koordinim të drejtpërdrejtë me zyrën e Ambasadës Britanike në Kosovë.

GLPS nuk mund të shfrytëzojë këtë Memorandum Bashkëpunimi për asgjë tjetër, pos për zbatimin e Projektit 'Monitorimi i Sistemit Gjyqësor dhe Prokurorial në Kosovë', financuar nga Ambasada Britanike në Kosovë, zbatuar nga Grupi për Studime Juridike dhe Politike.

Neni 5 [Parimet që qeverisin këtë Memorandum]

Palët pajtohen që në zbatimin e këtij Memorandumi të ndjekin parimet e transparencës së plotë, integritetit dhe angazhimit në mirëbesim ndërmjet tyre.

Neni 6 [Raportimi për zbatimin e Memorandumi]

GLPS pajtohet që çdo pjesë e zbatimit të këtij Memorandumi t'i raportohet Ambasadës Britanike në Kosovë.

Neni 7 [Zgjidhja e Memorandumit]

Palët mund të zgjidhin këtë Memorandum në rastet kur ekzistojnë kushtet objektive që e arsyetojnë një gjë të tillë.

Neni 8 [Kohëzgjatja]

Ky Memorandum vë bazat e bashkëpunimit në mes të KPK-së dhe GLPS-së deri në përfundim të Projektit, me datë 31 Mars 2020, mirëpo me mundësi vazhdimi dhe për dy vite të tjera.

Në rast të vazhdimit të kontratës së GLPS me donatorin, Ambasadën Britanike në Kosovë dhe për dy vite të tjera, atëherë palët në këtë memorandum pajtohen që bashkëpunimi vazhdon deri në përfundimin final të projektit, përkatësisht me datë 31 Mars 2022, me modalitetet e njëjta të përcaktuara në këtë memorandum.

Neni 9 [Nënshkrimi i Memorandumit]

Ky Memorandum nënshkruhet nga Palët dhe fillon së zbatuari nga dita e nënshkrimit të tij. Ky Memorandum Bashkëpunimi mund të plotësohet apo ndryshohet me marrëveshje me shkrim nga të dy palët. Ky Memorandum nënshkruhet në dy kopje të njëjta, nga një kopje për gjithsecilën palë.


Prezent si palë në nënshkrimin e këtij memorandum, në shenjë mirënjohjeje, do të jetë dhe Ambasadori i Britanisë së Madhe në Kosovë.


Palët Nënshkruese

Për KPK:

Bahri Hyseni
Kryesues i KPK-së



Për GLPS:

Arbëresha Loxha
Drejtoreshë Ekzekutive e GLPS



Data dhe Vendi: 20.05.2019